

PROCESVERBAL
nga mbledhja e 36-të e Këshillit të Agjencisë për
Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele,
të mbajtur më datë 29.09.2022

Anëtarët e pranishëm të Këshillit të Agjencisë: Lazo Petrushevski, kryetar i Këshillit të ASHMAA, Selver Ajdini zëvendëskryetar i Këshillit të ASHMAA, m-r Alma Mashoviq, d-r Metodija Jançeski, Lazar Trajçev, Zoran Fidanoski.

Anëtarë të Këshillit të Agjencisë që mungojnë: /

Në mbledhje ishte i pranishëm edhe d-r Zoran Trajçevski, drejtor i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.

Të pranishëm nga Shërbimi profesional: m-r Dragica Ljubevska, m-r Emilija Janevska, m-r Magdalena Davidovska Dovleva, Goran Radunoviq, m-r Ivona Mufisheva, m-r Aleksandar Xhuvarevqi, Maja Damevska, d-r Ivana Stojanovska.

Të pranishëm të tjerë: /

Z. Petrushevski e hapi Mbledhjen e 36-të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele. Seanca filloi në ora 14:00 dhe u realizua në hapësirat e Agjencisë.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi si vijon:

R E N D I T E

1. Miratimi i Propozim-procesverbalit nga mbledhja e 35-të Publike e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, të mbajtur më datë 16.09.2022.
2. Propozim-vendim për rritjen e planit financiar të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele për vitin 2022.
3. Propozim-Metodologjia për ndryshimin dhe plotësimin e Metodologjisë për realizimin e mbikëqyrjes programore (monitorimit) nr. 01-3905/1 nga data 23.07.2014.
4. Informatë në lidhje me Kërkesën e radiostacioneve komerciale në nivel shtetëror.
5. Propozim-vendim për pagesën e kompensimit për anëtar të familjes.
6. Propozim për dhënien e lejes për realizimin e procedurës së furnizimit publik për këtë lëndë të furnizimit publik – shërbime të Byrosë së përkthimeve.
7. Propozim për dhënien e lejes për miratimin e vendimit për furnizim me shërbime – trajnime në temë “Zbatimi i standardeve gjatë përgatitjes së specifikimeve teknike, përkufizimin e kritereve për konstatimin e aftësisë dhe ndjekjes/kontrollin e realizimit të kontratave të furnizimit publik”, me vlerë nën pragjet e vlerave për zbatimin e Ligjit për furnizime publike.
8. Propozim-rregullore për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për sistematizimin e vendeve të punës në Agjencinë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.

9. Të ndryshme.

Pika 1

Këshilli i Agjencisë e shqyrtoi dhe njëzëri e miratoi Procesverbalin e mbledhjes së 35-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, të mbajtur më datë 16.09.2022, me tekstin e propozuar.

Pika 2

Z.Trajçevski e arsyetoi Propozim-vendimin për rritjen e planit financiar të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale për vitin 2022. Sqaroi se në njërën nga mbledhjet e kaluara Këshilli ka konkluduar që të shqyrtohet mundësia e instalimit të fotovoltikëve në objektin e ASHMAA, me qëllim që të kursehet energjia elektrike për shkak të rritjes enorme të llogarive të energjisë së harxhuar elektrike.

Theksoi se Agjencia e shqyrtoi konkluzionin dhe konstatoi se për realizimin e procedurës patjetër duhet në fillim të përpilohet një studim fizibiliteti, e më pas të tregohet arsyetimi për të blerë pajisje që do të montohet në kulimin e Agjencisë. Për këtë qëllim parashihen 4.500.000,00 denarë, prej të cilave për përpilimin e studimit të fizibilitetit duhen 400.000,00 denarë dhe 4.100.000,00 denarë për projektimin, blerjen, montimin, realizimin dhe lidhjen në rrjetin energjetik të atij centrali fotovoltik që do të montohen në selinë e Agjencisë.

Gjithashtu informoi se Agjencia ka marrë një shkresë nga Qeveria e RMV-së ku një radiodifuzer ka kërkuar përkrahje financiare për organizmin e jubileut të "Turneut në futboll të vogël për medime" ku edhe do të ftohen përfaqësues të disa shteteve të rajonit dhe nëse ka mundësi ASHMAA mund të lejojë 250.000,00 denarë.

Për këto arsye Plani financiar i Agjencisë për vitin 2022 duhet të rritet sipas mjeteve që Agjencia i ka akumuluar nga vitet e kaluara. Potencoi se në fund të vitit për shkak të kursimeve të financave të furnizimeve publike, plani realisht edhe nuk do ta tejkalojë atë që ishte miratuar vitin e kaluar në dhjetor.

Z. Petrushevski tha se edhe ai pret të bëhet siç thotë drejtori, por për shkak të procedurave dhe arsyeve financiare patjetër duhet të vepohet në këtë mënyrë. Paratë patjetër duhet të jenë dhe të vihen në plan teorik, por në aspekt praktik nuk duhet patjetër të shpenzohen. Për shkak të fillimit të procedurës dhe për shkak të kontrollit të revizionit, aty ku patjetër duhet të tregohet se ka para për të filluar procedura, duhet patjetër që të sigurohen mjetet.

U prononcua se do ta përkrahë propozimin me votë pozitive. Mbledhjen e kaluar personalisht ka diskutuar dhe ka marrë përkrahje edhe nga anëtarët e këshillit, z.Fidanoski dhe Z. Trajçev, në lidhje me vendosjen e centralit fotovoltik në selinë e Agjencisë. Mbetemi në atë qëndrim, duke e cilësuar si hap të guximshëm dhe të mençur, që fatkeqësisht ky projekt nuk ka filluar të realizohet edhe më herët.

Z. Fidanoski u prononcua se do të japë përkrahje. Sqaroi se praktika e Agjencisë tregon se zakonisht ajo që planifikohet është shumë më pakë e shpenzuar, mirëpo është mirë që me vendim të sigurohen mjete për të gjitha nevojat prej përpara, por që nuk duhet patjetër të shpenzohen. tha se do t'i bashkëngjitet diskutimit të filluar nga z. Petrushevski rreth fotovoltikëve.

Ai jep përkrahje të fortë sepse konsideron se në situatë të këtillë me të cilën ballafaqohen të gjithë në botë ashtu edhe ne si shtet, me krizën e madhe potenciale energjetike në periudhën e ardhshme, së paku 6 muaj ose më shumë, është mirë që të shqyrtohet mundësia që Agjencia të ketë prodhimtari të energjisë elektrike për nevojat e veta. Ai potencoi dy momente.

Dy-tre ditët e kaluara, duke shfletuar informata të ndryshme në internet, i pari ishte shteti ynë. Në Kavadar për faktin që ishin vendosur foltovoltik në shumë institucione në qytet, komuna ka kursyer mbi 1 milion denarë gjatë muajit të kaluar, e që potencon se ka përfitim, varësisht nga nevoja.

Informata e dytë ishte në lidhje me kampionatin botëror në futboll 2026 që do të mbahet në tre shtete, Kanada, SHBA dhe Meksikë. Finalja është paraparë në SHBA në qytetin e Dallasit në stadiumin "Dallas Cowboys" i cili do të rinovohet për kapacitet rreth 100 mijë shikues, por kur e kishte shikuar fotografinë nga afër, lartë në kulmin e stadiumit kishte të vendosur panele fotovoltike që me gjasë do të shfrytëzohen për nevojat e energjisë elektrike të stadiumit. Për këto arsye konsiderohet se ky projekt do të jetë i suksesshëm dhe se në fund do të kemi, siç thotë populli "hajër" nga e gjithë kjo.

Z. Petrushevski tha se diskutimi i z.Fidanoskit e përkujtoi një informatë që e kishte lexuar këtë mëngjes, me kërkim nga Google ku ofrohet informata për këtë temë gjatë vitit, shpesh herë ka kërkuar informata për fotovoltikë.

Së këndejmë, në Kaliforni, Qeveria rajonale ka sjellë vendim që secili që do të parashtrijë kërkesë prej 40 kilovatë dhe amvisëri, jo vetëm firma, se nën atë vlerë, organi kompetent patjetër duhet të japë leje brenda një dite. Qëllimi është se me që Kalifornia është shtet shumë me diell, duhet që të gjithë të kenë fotovoltik nëpër kulmet e tyre.

Z. Ajdini tha se do të ndërlihet në diskutimin në lidhje me vendosjen e fotovoltikëve. Siç u theksua në mbledhjen e kaluar, nga diskutimet e z. Fidanoski dhe Z.Trajçev dhe se një investim i këtillë me siguri se do të kontribuojë për uljen e shpenzimeve, ndërsa nga ana tjetër edhe përfitimet do të jenë të mëdha. Me që pritjet janë se edhe viteve të kaluara do të ketë krizë të energjisë elektrike, tha se në tërësi do ta përkrah propozimin.

Z. Trajçev në lidhje me propozimin e fotovoltikëve të diskutuar në mbledhjen e kaluar ka shprehur përkrahje të plotë, veçanërisht nga se e ka dëgjuar edhe kryetarin e Komisionit Rregullator të Energjetikës që ka paralajmëruar në mënyrë shtesë rritje të çmimit të energjisë elektrike duke theksuar disa numra për krahasim me vitin e kaluar, ku p.sh nëse ka qenë 60 euro për një megavat orë, veç më ajo mbyllet në tremujorin e parë për 600euro duke supozuar sipas projekteve mund të arrijë deri në 1000euro e që është rritje e konsiderueshme e energjisë elektrike, ku Këshilli i Agjencisë si trup rregullator që duhet të përkujdeset për buxhetin dhe për mjetet shtetërore, është mirë që të kujdeset për buxhetin dhe për mjetet shtetërore, përmes masave që do të jenë në drejtim të kursimit të mjeteve e që ky vendim është i mirë në këtë aspekt.

Do të shihet se çfarë do të tregojë studimi i fizibilitetit që duhet të përpilohet, e që beson se do të tregojë se mund të vendosen panele, varësisht nga sipërfaqja, mundësitë teknike, etj. Tha se do të parashtrijet pyetje procedurale në aspekt të vetë vendimit me të cilën ndahet ndihma financiare, e me që tani përcaktohet edhe buxheti i ASHMAA, ndryshohet plani financiar, pyet se nëse duhet të theksohet subjekti për të cilin është donacioni, sepse në mbledhjet e ardhshme kishte një pikë të atillë për ndarje të mjeteve financiare – donacion e për të cilën do të votohet për miratim.

Pyet nëse në vetë vendimin duhet të qëndrojë edhe emri i subjektit për të cilin është donacioni, ose nëse duhet të qëndrojë vetëm ndryshimi ku do të përcaktojë atë pjesë të ndihmës financiare? Mendimi i tij është se duhet vetëm pjesa e përcaktuar, kurse nevoja se kujt i dedikohet dhe se a do të miratohet ose jo, është në arsyetimet e argumentimit në atë drejtim.

Z. Trajçevski tha se propozimi pranohet, andaj edhe propozimi që do të votohet nga Këshilli, duhet të jetë pa emrin e radiodifuzionit por vetëm si ndihëm financiare-donacion.

Z. Petrushevski tha se pajtohet dhe se do të bëjë një korigjim të vogël të propozimit, respektivisht në vendimin që miratohet nga Këshilli, të fshihet emri konkret i mediumit edhe në konkluzion. Me që edhe drejtori e pranon korigjimin, edhe për të është e pranueshëm dhe duhet të futet si propozim oficial për konkluzion.

Këshilli i Agjencisë me korigjim, njëzëri solli Vendim me të cilin miratohet rritja e Planit Financiar i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale për vitin 2022.

Me rritjen e propozuar të Planit Financiar për vitin 2022, të hyrat dhe shpenzimet e përgjithshme të planifikuara sipas planit do të rriten për 4.750.000,00 denarë, respektivisht do të jenë 148.504.238,00 denarë.

Mjetet e siguruara në shumë prej 4.750.000,00 denarë, do të jenë të dedikuara për:

- ndihmë financiare – donacion në vlerë prej 250.000,00 denarë, për përkrahjen e ngjarjeve dhe projekteve me interes publik për radiodifuzerët;
- Përpilimi i një studimi të fizibilitetit për arsyetimin e vendosjes së centralit fotovoltik në selinë e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale në shumë prej 400.000,00 denarë dhe
- Projektimi, blerja, montimi, realizimi dhe lidhja në rrjetin energjetik të një centrali fotovoltik në selinë e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale në shumë prej 4.100.000,00 denarë.

Sektori për Koordinimin dhe Përkrahjen e Punës së Drejtorit dhe të Këshillit të Agjencisë, vendimin e lartpërmendur ta publikojë në ueb faqen e Agjencisë.

Pika 3

Ndihmës-udhëheqësja e Sektorit për Çështje Programore m-r Emilija Petreska Kamenjarova e arsyetoi Propozim-Metodologjinë për ndryshimin dhe plotësimin e Metodologjisë për realizimin e mbikëqyrjes programore (monitorim) nr.01-3905/1 nga data 23.07.2014. Sqaroi se ky dokument paraqet propozim me tekst identik si edhe drafti që u miratua nga Këshilli në korrik të këtij viti. Për të kishte edhe debat të hapur publik prej 60 ditëve, por askush nuk parashtroi vërejtje, qëndrime, mendime ose propozime në aspekt të intervenimit në tekst. Ndryshimi dhe plotësimi i tërësishëm bëhet me qëllim të harmonizimit të vetë Metodologjisë me ndryshimet e Ligjit si dhe për shkak të faktit që disa prej akteve nënligjore ishin miratuar pas miratimit të metodologjisë.

Z.Petrushevski tha se me gjasë askush në shtet nuk ka pasur nevojë të propozojë diçka ndryshe, duke u prononcuar se do ta përkrahë dokumentin siç është propozuar, respektivisht ashtu siç ishte propozuar me versionin e draftit.

Këshilli i Agjencisë, njëzëri e miratoi Metodologjinë për ndryshimin dhe plotësimin e Metodologjisë për realizimin e mbikëqyrjes programore (monitorim) nr.01-3905/1 nga data 23.07.2014.

Spektori për Koordinimin dhe Përkrahjen e Punës së Drejtorit dhe të Këshillit të Agjencisë, vendimin e lartpërmendur ta publikojë në ueb faqen e Agjencisë

Z.Petrushevski, pas votimit propozoi që menjëherë të publikohet në faqen e Agjencisë, që ta dinë mediumet këtë për zgjedhjet e ardhshme, si dhe subjektet e tjera se çfarë mund të presin.

Pika 4

Z.Trajçevski e arsyetoi Informatën në lidhje me Kërkesën e radiostacioneve komerciale në nivel shtetëror. Sqaroi se para një muaji e gjysmë ishte informuar nga 4 radiot kombëtare, se po ballafaqohen me problem serioz në aspekt të rritjes enorme të llogarive të energjisë elektrike.

Potenco i se 4 stacionet kombëtare janë në gjendjen më të vështirë, krahasuar me të gjitha radiot dhe televizionet sepse kanë mbi 30 – transmetues në lokacione të ndryshme në shtet, dhe për secilin prej tyre paguajnë kompensime për energji elektrike. Njëri prej këtyre transmetuesve është i radiodifuzionit të Maqedonisë, mirëpo edhe aty paguajnë qira dhe llogari për energjinë e shpenzuar elektrike.

Me këtë veç më vihet në pikëpyetje funksionimi i tyre real, duke qenë në situatë që ndërprerjes së mundshme të punës. Duke marrë parasysh se ASHMA nuk mund që në aspekt financiar t'i përkrah për pagesën e llogarive të energjisë elektrike, propozohet që t'u jepet përkrahje nëse Qeveria ka mundësi që të sigurojë mjete financiare për tejkalimin e kësaj pozite tejet të pavolitshme në të cilën gjenden radiodifuzerët, sepse janë goditur të gjithë nga rritja e çmimit të energjisë elektrike, por që në veçanti më e theksuar është te radiot kombëtare dhe se duke marrë parasysh që në periudhën e ardhshme do të fillohet me përgatitjen e Planit Financiar të Agjencisë për vitin 2023, propozoi që t'u dilet në ndihmë radiodifuzerëve, jo vetëm 4 radiove kombëtare, por të gjithë radiodifuzerëve në kuadër të mundësive që Agjencia të sigurojë ndihmë prej 25% donacion, respektivisht ulje të kompensimit prej 25% që e paguajnë për emetim të radios dhe televizionit.

I bindur se po të mos ishte kjo rritje dramatike e llogarive për rrymë, Agjencia do të mund që edhe këtë vit ta lejojë uljen e kompensimit për 50%. Por, në këtë situatë në të cilën gjendet rregullatori, kjo është maksimumi që mund të ofrohet. Shprehu shpresë se nëse përmirësohet gjendja vitin e ardhshëm, Agjencia ndoshta do të ketë mundësi që ta rris këtë përqindje, mirëpo tani momentalisht ASHMAA nuk mund të mendojë në atë drejtim.

Z. Petrushevski e pyeti drejtorin nëse ky është viti i katërt ose i pestë që Agjencia ju ndanë ndihmë financiare radiodifuzerëve përmes uljes së kompensimit vjetor?

Z. Trajçevski u përgjigj se ky është viti i 5 të me çka tre vite, 2019, 2020 dhe 2021 në tërësi u janë kthyer paratë e kompensimit, respektivisht 100%, në vitin 2022 kishte ulje prej 50% dhe për vitin 2023 për 23%.

Z. Petrushevski tha se kjo me të vërtetë paraqet ndihmë serioze ndaj radiodifuzerëve dhe nuk beson se ndonjë institucion tjetër do ta lejojë atë. Tha se do ta përkrah propozimin,

sepse është propozim i ndershëm me që 4 radiodifuzerë kërkojnë, kurse ajo do të vlejë për të gjitha radiot dhe televizionet pa përjashtim.

Z. Ajdini tha se siç theksoi edhe drejtori, radiot kanë shpenzime më të mëdha në lidhje me transmetuesit, por duke pasur parasysh se kriza bëhet gjithnjë e më e vështirë, veçanërisht në veprimtaritë me interes publik, konsideron se është mirë kështu në mënyrë të përbashkët të tejkalohet kjo krizë duke ju ndihmuar radiodifuzerëve në këtë mënyrë. U prononcua se do ta përkrah propozimin.

Z. Fidanoski tha se Agjencia tani më vitin e 5-të jep ndihmë por nëse do të ketë mundësi do të vazhdojë edhe 15 vite, por beson se kjo përqindje që propozohet është maksimumi siç ka thënë z. Trajçevski, që mund të ofrohet duke mos u cenuar funksionimi normal i Agjencisë, si institucion duke dhënë ndihmë në këtë drejtim. Në aspekt të kërkesës së 4 radiove, gjithashtu jep përkrahje dhe për këtë duhet të miratohet konkluzion që Qeveria sipas mundësisë të sigurojë atë ndihmë financiare.

Sipas mundësisë, nuk sheh ndonjë pengesë që në mënyrë shtesë të dërgohet një shkresë deri te Qeveria. Mbrëmë e kishte ndjekur kryeministrin Kovaçevski, që kishte paralajmëruar çmim të rregulluar të rrymës për disa institucione ose veprimtari me interes publik dhe me që edhe kjo veprimtar ka interes publik, ndoshta edhe këto mund të hyjnë në kuadër të atij çmimi të rregulluar, nëse eventualisht ka përllogaritje të këtilla dhe nëse mund të miratohet ajo. Supozohet se me këtë shumë do të lehtësohen shpenzimet e përgjithshme për këto 4 radio. Pajtohet që shpenzimet janë të mëdha për ato transmetues që duhet të mirëmbahen, në mënyrë që sinjalit të vijojë me transmetim të papenguar.

Z. Petrushevski tha se dilema e vetme mbetet nëse edhe Qeveria do të veprojë si Agjencia, nëse kjo do të vrente vetëm për këto katër medime që të ketë ndonjë çmim të rregulluar, ose nëse ajo do të vlejë për të gjithë radiodifuzerët. Çështja është si të jetë qëndrimi i Këshillit në shkresë, se a e përkrahin kërkesën e tyre ose ata vetë të shtojnë se do të ishte mirë të ketë çmim të rregulluar për të gjithë mediumet. Do të dukej më humane në atë mënyrë të mos ndahen. Qartësoi se edhe drejtori pajtohet se shkresa është mirë të jetë për të gjitha mediumet.

Z. Petrushevski e hodhi propozimin në votim, Këshilli miratoi Konkluzion që një donacion prej 25% që do të realizohen vitin e ardhshëm dhe letra drejtuar Qeverisë të dërgohet menjëherë, që sipas mundësisë të sigurohet ndihmë financiare për distribucionin e sinjalit për mediumet.

Këshilli i Agjencisë e miratoi Informatën në lidhje me Kërkesën e radiostacioneve komerciale në nivel shtetëror nr. 03-3495/2 nga data 27.09.2022. Duke marrë parasysh ngjarjet aktuale me krizën energjetike dhe rritjen e madhe të çmimit të energjisë elektrike që drejtpërdrejt reflektohet në funksionimin dhe stabilitetin ekonomik të radiodifuzerëve dhe duke marrë parasysh rolin e konsiderueshëm që e kanë mediumet për pluralizmin dhe zhvillimin e shoqërive demokratike, Këshilli njëzëri e ka miratuar këtë konkluzion:

- Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale të sigurojë ndihmë financiare – donacion për radiodifuzerët, që do të realizohet përmes uljes për 25% të kompensimit të tyre për lejen e emetimit të radios dhe televizionit për vitin 2023, të përllogaritur në pajtim me formulën e përcaktuar në Ligjin për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale, dhe

- Të dërgohet një shkresë deri te Qeveria, nëse ka mundësi që të sigurojë ndihmë financiare për mbulimin e shpenzimit për distribucion të sinjalit për të gjithë radiodifuzerët.

Pika 5

Këshilli i Agjencisë, njëzëri i dha leje drejtorit të Agjencisë për miratimin e Vendimit për pagesës së ndihmës në para – kompensim për vdekjen e një anëtari të familjes më të ngushtë (babait), të një nëpunësi, në shumën prej 15.000,00 (pesëmbëdhjetë mijë) denarë.

Mjetet e lartpërmendura janë të siguruara me Planin Financiar të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele për vitin 2022.

Pika 6

Udhëheqësi i Seksionit për Furnizime Publike, m-r Aleksandar Xhuvareviq e arsyetoi Propozimin për dhënien e lejes për realizimin e procedurës së furnizimit publik për këtë lëndë të furnizimit publik – shërbime të Byrosë së përkthimeve. Sqaroi se bëhet fjalë për furnizime standarde në vlerë të vogël për një periudhë 2 vjeçare. Ky furnizim është i domosdoshëm për punën dhe funksionimin e Agjencisë.

Këshilli i Agjencisë njëzëri dha leje për zbatimin e procedurës për furnizime publike – shërbim: Byro të përkthimit.

Zbatimi i procedurës së furnizimeve publike për lëndën – shërbimin: Byro e përkthimeve është paraparë dhe është në pajtim me Planin vjetor të furnizimeve publike për vitin 2022 të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, ndërsa mjetet janë të siguruara me Planin financiar të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele për vitin 2022.

Pika 7

Udhëheqësi i Seksionit për Furnizime Publike, m-r Aleksandar Xhuvareviq e arsyetoi Propozimin për dhënien e lejes për realizimin e procedurës së furnizimit publik – trajnim në temën “Zbatimi i standardeve gjatë përpilimit të specifikimeve teknike, përkufizimit të kriterëve për konstatimin e aftësisë dhe ndjekjen/kontrollin e realizimit të kontratave të lidhura për furnizim publik”, me shumë të vlerësuar të nën pragjet e vlerës për zbatimin e Ligjit për furnizime publike.

Sqaroi se ky furnizim është nën vlerën e pragut prej 1000euro. Qëllimi i këtij furnizimi është sipas planit vjetor për parandalimin e korrupsionit në Agjenci. Qëllimi është që të punësuarit të njoftohen me krimin e specifikimeve teknike si dhe përkufizimin e kriterëve për konstatimit të aftësisë. Pas realizimit të trajnimit, pjesëmarrësit do të marrin certifikatë për vijimin e suksesshëm të trajnimit. Vlera e përlogaritur e trajnimit është 44.000,00 denarë pa TVSH.

Z. Trajçev tha se Këshilli nuk ndërhyr në mënyrën e zbatimit të furnizimit por dëshiron të potencojë se gjithmonë në situata të këtilla është më mirë që edhe pse vlera është e vogël, të kërkohen disa oferta nga ofertues të ndryshëm që e plotësojnë kualitetin e nevojshëm të shërbimit të ofruar.

Në treg ka disa kompani që e ofrojnë këtë shërbim. Ky është potencim i tij por prapë se prapë zbatimi i furnizimit është në kompetencë të Agjencisë dhe ajo do të vendos se si ta zbatojë.

Udhëheqësi Xhuvareviq sqaroi se me operatorin e përzgjedhur ekonomik veç më një kohë të gjatë Agjencia ka bashkëpunim ku janë realizuar disa trajnime përmes tyre.

Z. Petrushevski tha se deri më tani Agjencia ka pasur praktikë të këtyllë të më shumë ofertuesve dhe është mirë që kjo praktikë të vazhdohet edhe më tutje.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi vendimin për dhënien e lejes së furnizimit publik – trajnim në temën “Zbatimi i standardeve gjatë përpilimit të specifikimeve teknike, përkufizimit të kriterëve për konstatimin e aftësisë dhe ndjekjen/kontrollin e realizimit të kontratave të lidhura për furnizim publik”, me shumën e vlerësuar nën pragun për zbatimin e Ligjit për furnizime publike, në shumë prej 44.000,00 denarë, pa TVSH të përfshirë.

Mjetet e lartpërmendura janë të siguruara me Planin Financiar të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele për vitin 2022

Pika 8

Z. Trajçevski e arsyetoi Propozim-rregulloren për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për sistematizimin e vendeve të punës në Agjencinë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele. Sqaroi se në të ka një ndryshim të vogël vetëm në Sektorin për Përkrahje Informatike dhe Furnizime Publike, ku shtohet një vend i punës “bashkëpunëtor i lartë”

Këshilli i Agjencisë njëzëri e miratoi Propozim-rregulloren për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për sistematizimin e vendeve të punës në Agjencinë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, me tekstin e propozuara.

Spektori për Koordinimin dhe Përkrahjen e Punës së Drejtorit dhe të Këshillit të Agjencisë, vendimin e lartpërmendur ta publikojë në ueb faqen e Agjencisë.

Propozimi për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për sistematizimin e vendeve të punës në Agjencinë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele të publikohet edhe në tabelën e shpalljeve të Agjencisë.

Pika 9

Të ndryshme

Në këtë pikë nuk kishte diskutim.

**Nr. 02-3546/9
06.10.2022**

Shkup

**Agjencia për shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuele
Kryetar i Këshillit,
Llazo PETRUSHEVSKI, d.v**